



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 06.05.2025 dhe filloi në ora: 10:35.

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt e mbajtur me datë: 28.02.2025.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/226 datë:11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025
- 3.Shqyrtimi i Raportit 3 mujor Financiar janar-mars për vitin 2025
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i draft-plani i veprimt tre vjeçar për banim social 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2024.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2024.
- 7.Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit , Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr01/869 datë:23.07.2024 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik, sipërfaqja prej 400m²
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/523 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, (qëllime të tregut publik) dhe interesit publik , në zonën kadastrale në Carrallukë, Malishevë
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/522 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për formimin e komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes shprehjes së interesit në Malishevë.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/333 datë:17.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, përfundimi i procedurës së këmbimit të pronës publike me pronë private, sipas vendimit të Kuvendit nr.02/397 datë:11.09.2024.

12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr 01/369 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për inicimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publike, në komunën e Malishevës.

13.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/362 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr.01/35 datë:21.03.2025.

14.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/368 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për Formimin e Komisionit vlerësues, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes shprehjes së interesit në fshatin Bubavec, fshatin Shkozë dhe në Qytetzën e Malishevës, KK-Malishevë.

15.Shqyrtimi i kërkesave

16.Të ndryshme.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Hamit Lima, Sadik Vranezi, Këshilltar ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, përfaqësuesi nga OSBE Sead Raba dhe zyra për informim.

Mungon: Arlindë Rudi (PDK).

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur! Hapi mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 6 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kërkoj që pika e nëntë Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr01/869 datë:23.07.2024 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik, sipërfaqja prej 400m² të largohet nga rendi i ditës. Kush është për që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës?

Me vota unanime të 6 anëtarëve kjo pikë largohet nga rendi i ditës.

Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime të gjashtë anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua rendi i ditës me plotësim ndryshime.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt e mbajtur me datë:28.02.2025.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për miratimin e procesverbalit?

Me vota unanime të 5 anëtarëve, kalon kjo pikë.

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/226 datë:11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Drejtori Blerim është prezent dhe na prezanton.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Pas përfundimit të vitit fiskal 2024 mbetet në fondin burimor 21 të hyrave vetanake kapin shumën prej 338,743.92E, e cila duhet të bartet në vitin 2025. Ne, si drejtori e financave, duke pasur parasysh obligimet dhe dëmi që është shkaktuar nga përmbaruesi për qështjen e shujtave të mësimdhënësve këtë vit në pjesën e kapitaleve, kemi planifikuar që shuma prej 200,000.00€ të kalojë në projektin e rregullimit të sheshit të qytetit të Malishevës.

Shuma prej 85,743.92€ është planifikuar që të shkojnë në asfaltimin e rrugëve në fshatrat Ngucat, Kërvasari, Llapqevë, Mirushë, Bubavec, dhe këtu kemi obligime dhe kontrata të pa përfunduara që mendojmë se këtë vit të përfundohen dhe për t'i përmbyllur këto duhet mjete shtesë.

Shuma prej 50,000.00€ kemi kërkuar që të bartet për renovimin e objekteve shkollore në fshatrat e Malishevës, dhe 3,000.00€ të bartet për mallra dhe shërbime.

Kërkojmë nga asambleja që kjo pikë të miratohet.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Te kjo pike dua të ndalem te qështja tek renovimit të objekteve shkollore. Dua të di në cilat shkolla janë kryer këto renovime dhe sa është shuma totale e kontratës për të cilën komuna ka ende obligime pa u përfunduar.

Te asfaltimi i rrugëve janë përfshirë fshatrat, Ngucat, Kërvasari, Llapqevë, Mirushë, Bubavec. Mendoj se do të ishte më mirë që në asamble të na vinë dhe se cilat rrugë planifikohen të rregullohen.

Shuma prej 200,000.00€ që është planifikuar për sheshin, më duket mjaft e lartë. Ndoshta do të ishte më mirë ti shikojmë dhe kategoritë e tjera dhe të bëjmë një rishpërndarje.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Sa kam informacion kontrata kap vlerën 300,000.00€, është kontratë dy vjeqare. Punimet i ka përfunduar, në cilat shkolla nuk e di. Tek qështja e rrugëve janë këto tri kontratat, një është me dy loto ndërsa dy kontratat janë me nga një loto. Kjo kërkesë që është bërë është pothuajse përfundimi i njërës kontratë.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Këto 50,000.00E tek sheshi a mundemi me i vendos tek asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Më mirë është të përfundohet sheshi, sepse tani është dhe koha e mërgimtarëve. A janë përfunduar pagesat e shujtave apo ka ende.

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet e Financa): Ka ende.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.04/226 datë:11.04.2025 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin fiskal 2025? Me vota unanime të 5 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë tek pika shqyrtimi i Raportit 3 mujor Financiar janar-mars për vitin 2025. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Kuvendi Komunal ka një buxhet të miratuar në shumë prej 21,576,545.00E për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj i shtojmë dhe shumën prej 326,448.73E nga Qeveria Zvicerrane “Granti i Përformances” dhe shuma prej 1,122.85E disa donacione të vogla të bartura nga shumë vite, del se buxheti i futur në SIMFK si buxhet përfundimtar kap shumën prej 21,904,116.50E.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë kap shumën prej 12,005.133.74E që në përqindje i bie 65.06%. Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për periudhën janar-mars 2025 është 7,810,854.70 që në përqindje i bie 65.06%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 36.20%.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2025, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mbliidhen 1,505,526.00E. Nuk është marrur pjesa e të hyrave të tre mujorshit nga gjobat në trafik dhe gjykata.

Sipas shënimeve aktuale janar mars 2025, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është 14%.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Vërehet një performancë e mirë në këtë aspekt të inkasimit të të hyrave vetanake nga ana e komunës.

Tek tabela periudhat e njëjta kohore mes vitit 2024 dhe 2025 po i përmendi këtu: shpenzimet për informim publik në vitin 2024 kanë qenë 10,000.00E ndërsa në vitin 2025 janë 1,162.00E këtu është një ulje në raport me vitin 2024.

Shpenzimet për internet në vitin 2024 kanë qenë zero ndërsa në vitin 2025 janë 12,192.00E.

Shërbime të ndryshme shëndetësore në vitin 2024 janë 2,281.00E, ndërsa në vitin 2025 janë 182,222.00E.

Shërbime teknike në vitin 2024 janë 14,543.00E, ndërsa në vitin 2025 janë 23,405.67E.

Shpenzime për anëtarzim në vitin 2024 kanë qenë 15,571.86E, ndërsa në vitin 2025 janë 67,544.85E.

Paisje tjera në vitin 2024 janë 1,468.00E, ndërsa në vitin 2025 janë 3,515.00E. Blerja e librave në vitin 2024 janë zero, ndërsa në vitin 2025 janë 20,877.90E. Pse në vitin 2024 nuk ka pasur blerje të librave?

Paisje sportive zero në vitin 2024, ndërsa 19,297.60 në vitin 2025.

Furnizim i zyreve në vitin 2024 është 18,793.92 ndërsa në vitin 2025 janë 41,775.47E.

Dru ndoshta kjo kontratë është e vitit 2024 sepse ska logjik nesë është bërë tani.

Karborant për vetura zyrtare në vitin 2024 janë 13,052.00 ndërsa në vitin 2025 janë 33,392.67E. Është shumë e lartë, na shpjego dhe për këtë?

Mirëmbajtja e ndërtesave në vitin 2024 kanë qenë 66,268.91 ndërsa në vitin 2025 janë 102,545.49E.

Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve zero është në vitin 2024 ndërsa në vitin 2025 janë 19,696.20E.

Kompenzim përfaqësimi jashtë vendit në vitin 2024 është 5,261.00E ndërsa në vitin 2025 janë 15,353.40E.

Vendimet e gjykatave në vitin 2025 janë 240,907.86E. Te pjesa e investimeve kapitale- tek ndërtesat arsimore, në cilat shkolla është investuar në vitin 2024 janë 165,995.44E ndërsa në vitin 2025 janë 297,062.91E.

Fusha sportive në vitin 2024 kanë qenë zero në vitin 2025 janë 77,201.17E.

Ndërtesa shëndetësore zero kanë qenë në vitin 2024 ndërsa në vitin 2025 janë 102,784.00E.

Shtretër lumenj në vitin 2025 janë 180,000.00E në cilat zona janë bërë.

Paisje tjera këtë emërtim nuk po e di se për qka po bëhet fjalë në vitin 2025 janë 265,000.00E ndërsa në vitin 2024 kanë qenë zero.

Vendime gjyqesore në vitin 2025 janë 532,332.42E.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Krahasoni me vitin paraprak dhe këtë vit e dikton ekzekutimi i kësaj lënde përmbartimore që janë marrur në shkurt, dhe kjo e bënë krahasimin shumë të lartë. Kemi kryer dhe pagesa tjera mirëpo qështja është tek lëndët përmbartimore. Tek blerja e librave kemi bërë pagesë, ka qenë kontratë dy vjeqare. Tek dru kemi bërë pagesa që kanë qenë të viteve të kaluara. Mirëmbajtja e ndërtesave është kjo në komunë dhe në institucionet tjera. Vizita zyrtare ka raste që kemi pasur të viteve të kaluara dhe i kemi përfunduar tani. Ndërtesa shkollore, e kemi pasur shkollën e Turjakës 200,000E ku është duke u punuar dhe kanë qenë dhe disa rinovime të shkollave. Tek pjesa e lumenjëve është në kontratë të mirëmbajtjes së rrugëve dhe lumenjëve dhe mirëmbajtjet verore dimrore nga operatori, është një kontratë dhe ka qenë shuma 180,000.00E. Paisjet mjeksore, ne kemi furnizim dhe kontratë me paisje teknike të shërbimit për shëndetësi. Ku ishte shërbimet shëndetësore, se pse dallon periudha e shpenzimit 2024 me 2025, me sa di unë është ndërprerë një kontratë tek shërbimet shëndetësore në vitin e kaluar dhe është rishpallur dhe ndoshta është ajo periudhë ku nuk ka qenë e mbular me kontratë dhe nuk kemi pasur shpenzim.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend Raporti 3 mujor Financiar janar-mars për vitin 2025?

Me vota unanime të pesë anëtarëve kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-plani i veprimtimit tre vjeçar për banim social 2025-2027.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Fadili sot nuk mund të vijë për prezantim mirëpo ne po e rekomandojmë për Kuvend.

Kush është që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime të 5 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kuvendit për vitin 2024

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Ky Raport është gjithëpërfshirës dhe është dërguar tek ju. Kush është që ky Raport të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime të gjashtë anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Kryetarit të Komunës janar-dhjetor 2024.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Për shkak të disa qështjeve teknike Raporti kryetarit nuk është ardhur me kohë. Sot e kemi marrur në email dhe është dërguar tek ju. Kush është që ky Raport të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime të gjashtë anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Pika e shtatë: Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit , Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Me vota unanime të gjashtë anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvendi.

Pika e nëntë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/523 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, (qëllime të tregut publik) dhe interesit publik , në zonën kadastrale në Carrallukë, Malishevë.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Kërkesa e kryetarit ka të bëjë për qëllim të inicimit të procedurës për me dhënë në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike. Prona është në zonën kadastrale në Carrallukë, përballë varrezave të dëshmorëve. Në posedim e kanë disa palë private, por në librat kadastral regjistron si pronësi e kuvendit komunal. Qëllimi është me dhënë në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vjet për qëllime të vendosjes së tregut publik të komunës së Malishevës.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): A është fjalë për këtë tregun që është këtu që të bartet në atë pjesë.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Ky është treg privat që njerëzit vinë dhe e paguajnë shfrytëzimin e atyre tendave një pronarit privat, mirëpo është kompetencë ligjore e Kuvendit që me dhënë leje licencë për tregun publik.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Do ishte mirë që kësaj kërkesë kopjen e pronësisë dhe me na dhënë emrat e atyre pronarëve aktual që janë duke e shfrytëzuar atë hapsirë. Unë e kam si dilemë se si do zgjidhet kjo, a do të ketë marrëveshje paraprake me ata privat që janë duke e shfrytëzuar atë pjesë dhe pastaj ata ta kenë të drejtën e shfrytëzimit të tregut apo d të jetë kompetencë e komunës që të shkojë sipas procedurave ligjore dhe aplikon secili qytetar pasi është pronë publike. Këto sqarime është mirë të na jap kryetari.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Ligjërisht mundem me thënë me kompetencë të plotë që ka me u zhvillu kjo e dyta që po e thua ti. Ka me u caktuar lokacioni, ka me u bërë shpallja publike, ka me u formuar komisioni për me i zhvillu procedurat, do të bëhet shpallja për aplikim, leximi i ofertave dhe pastaj prapë do të vijë në kuvend.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Sa kam njohuri për këtë parcelën që flitet ata ka disa vite që e punojnë dhe sa e di ata janë në proces gjyqësor për atë parcelë dhe përderisa është proces gjyqësor ajo parcelë që ata pretendojnë që është pronë e tyre, unë mendoj që është e pardrejt nga ne me shty komunën me dhënë në shfrytëzim. Unë kisha kërkuar që kjo të hiqet nga rendi i ditës. Njëherë de ta merr komuna si pronë të vetën dhe jo ne si Kuvend me vendos dhe me rënë ne në lajthitje. E kemi rastin në Banjë, u bënë tre vite që është marrur vendimi për parcelë për mbeturinat dhe në vendin e caktuar për mbeturina dhe ende

funksion i njëjti. Unë do të votoj kundër, dhe kur ta merr komuna mbi veti pastaj jam pro këtij tregu, mirëpo jo në këtë mënyrë.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Kjo kërkesë po më duket e qëlluar, sepse ne si Komunë e Malishevës problemim më të madh e kemi tek komunikacioni ditën e enjete ku bëhet tregu në qendër të Malishevës.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për rekomandim për kuvend të kërkesës nr.01/523 datë:02.05.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, (qëllime të tregut publik) dhe interesit publik, në zonën kadastrale në Carrallukë, Malishevë?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

Pika tjetër është formimi i Komisionit për të cilin skemi qa me diskutuar dhe në Kuvend e formojmë.

Pika e 11: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/333 datë:17.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, përfundimi i procedurës së këmbimit të pronës publike me pronë private, sipas vendimit të Kuvendit nr.02/397 datë:11.09.2024.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Është një pronë që Kuvendi e ka lejuar këmbimin në Malishevë, lagjja Mirdita. Është bërë vlerësimi në Ministrinë e financave, flitet për 38m dhe Ministria e Financave e ka vlerësuar me qmim të njëjtë dhe vlerën e pronës publike dhe atë private. Tani në Kuvend duhet me votuar këmbimin, pra është procedurë ligjore. Nëse ju e votoni lejohet këmbimi dhe pas ligjshmëris nga MAPL-ja, kryetari e bënë kontratën për këmbim.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.01/333?

Për: 5,

Kundër: 0

Abstenim: 1

Pika e 12: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/369 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për iniciimin e procedurës administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe interesit publike, në komunën e Malishevës.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Është fjala për zonën kadastrale në Shkozë një sipërfaqe prej 40h, në fshatin Bubavec në sipërfaqe prej 10h dhe në Dragobil 9H.

Ne kemi me shpallë zonë me interes atë 40h për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, afariste dhe sa e di aty është e planifikuar me bërë panele solare, nëse qeveria nuk ndërhy.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Kush është për rekomandim për kuvend kërkesën nr. 01/369 datë:27.03.2025?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

Pika e 13: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/362 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr.01/350 datë:21.03.2025.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Propozim për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr. 01/35 datë: 21.03.2025 e parashtruar nga DHV company, të cilët kanë kërkuar këmbimin e pronës private me pronë publike

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Pa vendim të kuvendit dhe pa ligjshmëri të Ministries nuk kemi të drejtë me bërë këto zhvendosje.

Argjend Thaçi (Kryesues i kuvendit): Kush është të për miratim të kërkesës nr.01/362 datë:27.03.2025 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr.01/350 datë:21.03.2025? Me vota unanime të gjashtë anëtarëve kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

E kemi një kërkesë nr.02/166 datë:02.04.2024, e parashtruar nga Zenun Krasniqi nga fshati Astrazup, i cili kërkon kompenzim e pronës private të cilën më është marrur gjatë ndërtimit të rrugës Astrazup- Burim. Të bashkangjitur ka numrat e parcelave.

Muharrem Morina (Zyrtar Ligjor i Kuvendit): Ka qenë sot tek Kryetari dhe tek unë, 16 ari kur është shtruar rruga është shtruar nëpër parcelë të tij dhe të vllaut të tij. Trajtohet kërkesa e palës, i shpallim 16 ari zonë me interes të përgjithshëm në emër të rrugës psh: Kuvendi komunal dhe ato ngastra ai që ai ka pretenduar ne i marrim i dërgojmë për vlerësim në Ministri.

Hamit Lima (anëtar i LDK): Me qfarë të drejte shtrohet rruga pa e ditur toka e kujt është. A duhet dikush të jep përgjegjësi për këto që po ndodhin?

Këso rastësi ka ndodhur dhe në fshatin Banjë, dhe është normale që duhet me kërkuar kompenzim.

Argjend Thaçi (Kryesues i kuvendit): Kush është që kërkesa kërkesë nr.02/166 datë:02.04.2024 të rekomandohet për Kuvend?

Për: 4

Kundër: 2

Abstenim: 0

E kemi një kërkesë nr.02/85 datë: 07.04.2025, e parashtruar nga Organizata e Veteranëve të luftës së UÇK-së) dega në Malishevë, të cilët kërkojnë mbështetje nga Kuvendi për pasjet për organizatën tonë me inventar të nevojshëm për zyret që gjenden aty.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Mua po më qudit që ende nuk është përfunduar kjo qështje

Kush është për që kërkesa nr.02/85 të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime të 6 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë tek shqyrtimi i kërkesave. I kemi dy kërkesa të cilët janë invalid të luftës dhe janë me sëmundjen e kancerit, Zenel Thaçi dhe Tafë Krasniqi. Kërkesa tjetër është nga Leonorë Morina e cila bënë kërkesë për bashkëshortin Fatmir Kryeziu i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore. Kërkesa tjetër është nga Anita Shurdhaj e cila është me kancer. Kërkesa tjetër është nga Fatjonë Shala e cila është me kancer. Kush është që kërkesat nr.02/94, 02/84, 02/35, 02/25, 02/118 të rekomandohen për kuvend?

Me vota unanime të 6 anëtarëve të rekomandohet për kuvend.

Kërkesa 02/306, 02/30, 02/474, 02/52, 02/18, 02/111 këtyre kërkesave po ju ndajm nga 500, një kërkesë është për një gjudiste ndërsa të tjerat janë shëndetësore. Kush është që këtyre kërkesave të ju ndahen nga 500E?

Me

vota unanime të gjashtë anëtarëve këtyre kërkesave ju ndahen nga 500E.

Kërkesa 02/255, 02/437, 02/414, 02/ 16, 02/617, këtyre kërkesave ju ndahen nga 400E, të gjitha kërkesat janë shëndetësore. Kush është që këtyre kërkesave të ju ndahen nga 400 euro për secilën kërkesë?

Me vota unanime këtyre kërkesave ju ndahen nga 400E.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Ju falënderojë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:05.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

